



# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
  - \* Aktivitetet nga Programi për hulumtime dhe Publikime
- \* Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
  - \* Aktivitetet tjera

Dhjetor 2019

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Etika Profesionale

#### Gjyqtaret që nuk e kanë përfunduar trajnimin përmes platformës së mësimimit në distance GR. I

Më 03 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, në mbështetje të GIZ – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative ka realizuar trajnimin e obligueshëm “Etika profesionale” për gjyqtarët që nuk e kanë përfunduar trajnimin përmes platformës së mësimimit në distance, GR. I.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të përfituesve me standardet e kodit të etikës dhe pozicionit të kodit të etikës në raport me përgjegjësin dhe procedurën disiplinore.

Në fokus të këtij trajnimi kanë qenë Kodi i Etikës dhe parimet bazë të etikës profesionale siç janë pavarësia, paanshmëria, barazia, integriteti, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë, konfidencialiteti dhe raportet me

publikun dhe mediat, rregullorja për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme, definimi i sjelljeve të pahijshme, kategorizimi i sjelljeve të pahijshme, përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve. Po ashtu gjatë trajnimit në pika të shkurta është diskutuar edhe për Panelin Hetimor dhe mënyrën e themelimit, dhe mandatin e panelit Panelit Hetimor.

Trajnimi është realizuar përmes prezantimit teorik duke u shoqëruar me pyetje dhe diskutim interaktiv në mes të pjesëmarrësve dhe trajnuesve të angazhuar për të trajtuar këtë temë. Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, si dhe gjyqtarë të gjykatave themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës, të cilët nuk kanë pasur mundësinë të ndjekin trajnimin përmes platformës së mësimimit në distancë.



## Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës

Më 03 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim dhe me përkrahjen e Zyrës së UNHCR-CRP/K organizoj trajnimin me temë: “Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës” në kuadër të PTV-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurat ligjore që zhvillohen ndaj të huajve në Republikën e Kosovës.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: Hyrja në territorin e Kosovës, qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës dhe procedura ligjore e mbajtjes dhe dëbimit të të huajve nga Republika e Kosovës sipas Ligjit për të Huajt si dhe qëndrimi i paligjshëm, kthimi dhe dëbimi i të huajve. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtua e drejta ndërkombëtare e refugjatëve.

Që në fillim u theksua se lëvizja dhe qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës është rregulluar me Ligjin për të Huajt, nr.04/L-219, i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për të Huajt nr.06/L-036. Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Dispozitat e këtij ligji janë në pajtim me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe të individëve sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtat ndërkombëtare të njeriut, në veçanti, Konventën e vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve, parimin e mos dëbimit (non-refoulement) dhe të drejtën për të kërkuar azil të përfshira në to.

Në këtë trajnim dominuan çështjet për statusin dhe qëndrimin e të huajve, procedura ligjore e mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të dispozitave të Ligjit për të Huajt. Duke marr parasysh se ky ligj rregullon

hyrjen në territorin e Kosovës dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës procedurat që zhvillohen lidhur me këto u trajtuan në gjerësi dhe nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore, si dhe dispozitave për integrimin e të



huajve në shoqërinë kosovare.

Këto çështje dhe dilemat që ndërlidhen me statusin dhe qëndrimin e të huajve, procedurën ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës u trajtuan sipas dispozitave të Ligjit për të Huajt si dhe zbatimin e drejtë të tyre nga organet kompetente. Fokusi ishte edhe në çështjet e kategorive se ndaj kujt zbatohen dispozitat e Ligjit për të huajt dhe ndaj cilës kategori nuk janë të zbatueshme.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore, u zbërthyen dispozitat dhe standardet ndërkombëtare dhe nacionale në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Departamentit për Çështje Administrative dhe bashkpunëtorët profesional, Zyrtarë të Departamentit të Policisë Kufitare, DSHAM-MPB, zyrtarë të UNHCR-it dhe shoqërisë civile (KRTC dhe CRPK) dhe të tjerë.

## Mjetet e goditjes në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Më 04 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Mjetet e goditjes në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës” në kuadër të PTV-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me mjetet e goditjes në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.



Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan Ankesa si mjet i vetëm i goditjes dhe kufijtë e shqyrtimit të saj dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan afatet për paraqitjen e ankesës, dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Që në fillim u potencua se Ligji për Dhomën e Posaçme (LDHP) si ligj i veçantë që aplikohet nga DHPGJS në nenin 9.6 e parasheh ankesën si mjet i vetëm juridik i goditjes së vendimeve gjyqësore të lëshuara nga Kolegji i formuar sipas nenit 9.4 të këtij ligji ( lëndët pronësore dhe të privatizimit) dhe vendimeve të lëshuara nga gjyqtari i vetëm (lëndët tjera nga jurisdiksioni i DHPGJS-së).

Me ankesë mund të goditen të gjitha llojet e vendimeve gjyqësore të lëshuar nga kolegjet e specializuara, me përjashtim të aktgjyqimit për mosparaqitje që mund të ushtrohet kërkesë. Me ankesë si mjet i goditjes mund të kundërshtohen të gjitha vendimet apo veprimet e AKM-së, apo Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilën refuzohen kërkesat pronësore, kreditore kundër ndërmarrjeve që janë futur në procedurë të likuidimit, ankesat që kanë të bëjnë me listën

zyrtare të punëtorëve që kanë të drejta legjitime për të marr një pjesë në 20% të ardhurave nga çmimi i shitjes së ndërmarrjes shoqërore, ankesat që kanë të bëjnë me likuidimin e një ndërmarrje sipas autorizimit administrues të Agjencisë dhe ankesat apo kundërshtimet për anulimin e transaksioneve të ndonjë ndërmarrjeje që i është nënshtruar procedurës së likuidimit.

Procedura sipas ankesës para gjykatës zhvillohet në dy nivele: në të parin vepron Kolegjet e Specializuara, në të dytin Kolegji i Apelit.

Me nenin 9.14 i LDHP-së që aktualisht është në fuqi, është përcaktuar se “të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër”. Ky formulim ligjor i kësaj dispozite ligjore i heq të gjitha dilemat për mos aplikueshmërinë e mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve gjyqësore në procedurat para DHPGJS-së, të cilat aplikohen në procedurat kontestimore në sistemin e gjykatave të rregullta. Mirëpo, çdo palë e pakënaqur me vendimin gjyqësor të Kolegjit të apelit, mund të paraqesë kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së vendimit në fjalë.

Në këtë trajnim janë përdorë metodat e shpjegimit të pjesëshëm teorik, diskutime interaktive, analizës së rasteve nga praktika gjyqësore si dhe shembuj të vendosjes meritore në raste konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, gjyqtarët e gjykatave themelore- departamentet e përgjithshme- divizionet civile, zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.

## **Program i Specializuar - Trajnimi në Forcimin e Kapaciteteve profesionale në Luftimin e Krimit Kibernetik Sesioni III**

Më 04-05 Dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin e specializuar me temë “Trajnimi në Forcimin e Kapaciteteve profesionale në Luftimin e Krimit Kibernetik, Sesioni III”

Trajnimi kishte për synim avancimin e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërkombëtar në luftimin e krimit kibernetik.

Në fokus të këtij sesioni trajnues ishin bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit kibernetikë, institucionet kompetente që merren me këto vepra dhe veprat tjera që lidhen me krimin kibernetik, mundësitë e ndjekjes së suksesshme të e-krimit ndërkombëtar dhe krimit kibernetik.

Trajnimi u zhvillua përmes diskutimeve interaktive, dhe me trajtimin e rasteve praktike, ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre.

Gjithashtu në këtë trajnim u përdorën metodat e krahasimit të legjislacionit vendor me atë ndërkombëtarë që e sanksionojnë krimin kibernetik si dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në luftimin e kësaj dukurie.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykatat Themelore, Prokuror nga Prokuroritë e Republikës së Kosovës.



## Përmbartimi i vendimeve gjyqësore në çështjet familjare dhe kontestet e punës

Më 05 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ, realizoi trajnimin me temë: “Përmbartimi i vendimeve gjyqësore në çështjet familjare dhe kontestet e punës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan organi përmbartues, kompetenca, vendimet e organit përmbartues dhe përmbajtja e tyre. Në pjesën e dytë u trajtuan baza juridike për caktimin e përmbartimit tek rastet e kthimit të punëtorit në punë dhe dorëzimit të fëmijës, si dhe veprimet e organit përmbartues dhe mënyra e zbatimit të përmbartimit.

Në trajnim u theksua që roli i gjykatave mbetet mjaftë i rëndësishëm, sepse çështjet me të ndjeshme siç janë çështjet familjare dhe kthimi i punëtorit në punë mbasin në kompetencë ekskluzive të gjykatave. Po ashtu mjetet juridike mbasin në vendosje të gjykatave, si dhe funksion tjetër i rëndësishëm është mbikëqyrja,

sepse palët të cilët mendojnë se përmbartuesi privat ka shkelur ndonjë të drejtë të tyre mund ti drejtohen gjykatës. Më tej u potencua që duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit përmbartues dhe përmbartimi të jetë sa më pak i dëmshëm për debitorët gjatë zbatimit të procedurës së përmbartimit.

Gjatë këtij trajnimi nga trajnuesit u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, ku patën rastin që pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës, duke marrë pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe me prezantuesin.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë të nivelit themelor, Gjykata e Apelit, Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme si dhe bashkëpunëtor profesional nga Gjykatat dhe Prokuroritë.



## Punëtori mbi “Harmonizimin e çasjes ndaj Politikës Ndëshkimore”

Më 5 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, Zyra në Prishtinë/OPDAT, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi punëtorinë mbi “Harmonizimin e çasjes ndaj Politikës Ndëshkimore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë në zbatimin në praktikë të udhëzuesit i cili ka ndikim pozitiv që politika ndëshkimore të bëhet me unifikuese në të gjitha gjykatat.

Me rastin e kësaj punëtorie u vu në pah që kryerësit e veprave penale të natyrës së njëjtë dhe rrethanave për afërsisht të njëjta nuk kanë konsistencë në dënime prej një gjykate në tjetrën. Më tej me rastin e shqiptimit të dënimeve vërehet se është bërë vlerësim joadekuat i rrethanave dhe po ashtu nuk ka arsyetim të mjaftueshëm të këtyre rrethanave.

Vëmendje gjatë trajnimit iu kushtua, rrethanave lehtësuese dhe rënduese karakteristike e të cilave është se nuk janë shterruese pra, mund të

merren edhe rrethana tjera. Gjithashtu u theksua se rrethanat rënduese janë të prira për të qenë më specifike dhe të qarta sesa rrethanat lehtësuese.

Përveç kësaj, në fokus të kësaj punëtorie ishte rëndësia e bashkëpunimit me Shërbimin sprovues me theks të veçantë në caktimin dhe implementimin e dënimeve alternative si dhe roli dhe angazhimi i prokurorëve në gjetjen dhe prezantimin e rrethanave relevante lehtësuese dhe rënduese qysh në fazat e hershme të hetimit të rasteve. Paraprakisht objekt trajtimi ishte çasja më unike në caktimin e gjobave dhe përparësia e caktimit të dëmshpërblimit.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, dhe puna në grupe ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë dhe bashkpunëtor profesional të regjionit të Mitrovicës.



## Procedura penale para fillimit të hetimit

Më 11 dhjetor 2019 Akademinë e Drejtësisë në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Procedura penale, para fillimit të hetimit”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me rëndësinë dhe vlerën provuese që kanë provat e mbledhura në procedurën penale para fillimit të hetimit si dhe zbatimi i drejtë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Ky trajnim trajtoj veprimet policore të cilat kryhen nga policia dhe raportimi i këtyre veprimeve tek prokurori i shtetit. Vëmendje të veçantë kishte procedura e mbledhjes së informacioneve për arritjen e standardit të dyshimit të arsyeshëm për një veprë penale, zbulimin e kryerësit të veprës penale, vendndodhjen e tij, ndalimin e kryesit ose ndihmësit nga fshehja ose arratisja, zbulimi dhe e ruajtja e gjurmëve dhe provave tjera të veprës penale. Më tej u diskutua edhe për sendet të

cilat mund të shërbejnë si provë dhe mbledhja e të gjitha informacioneve të cilat mund të përdoren në procedurën penale.

Me rastin e këtij trajnimi vëmendje dhe trajtim i veçant i’u kushtua besueshmërisë dhe fuqisë provuese të informacioneve dhe provave të mbledhura në procedurën parapenale nga ana e zbatuesve të ligjit.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive i shoqëruar me shembuj praktik ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor nga të gjitha regionet e Kosovës si dhe bashkëpunëtor profesional.





## **E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve - Neni 8 i KEDNJ**

Më 12 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve - Neni 8 i KEDNJ” në kuadër të PTV-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e drejtë të dispozitave të nenit 8 të KEDNJ.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan nocioni dhe natyra juridike e jetës private dhe kuptimi e natyra juridike e jetës familjare. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan privatësia, korrespondenca, vendbanimi-përgjimi dhe mbledhja e të dhënave dhe ndërhyrja e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejte në shkallën e parashikuar me ligj.

Që në fillim u potencua se interpretimi i gjerë që i jep Gjykata nocionit të jetës private sipas Nenit 8 të Konventës përfshinë element të tillë si identifikimi gjinor, emri, orientimi seksual dhe jeta seksuale. Neni mbron gjithashtu të drejtën për identitet dhe zhvillim personal dhe të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhëniet me persona të tjerë dhe me botën e jashtme, duke përfshirë aktivitete të një natyre profesionale apo biznesi që mund të krijohen në kontekstin publik. E drejta private është e lidhur ngushtë me nocionin e integritetit personal. Çdo lloj ndërhyrjeje në integritetin fizik të një personi duhet të parashikohet me ligj dhe kërkon miratimin nga ai person.

Gjithashtu u potencua se koncepti i jetës së familjes është zhvilluar në mënyrë të ngadaltë gjatë jetëgjatësisë së Konventës dhe vazhdon të zhvillohet duke marrë parasysh ndryshimet sociale dhe ligjore. Gjykata, ashtu si për konceptin e jetës private, mban të njëjtin qëndrim të ekuilibruar në interpretimin e jetës së familjes duke pasur parasysh diversitetin e problemeve të familjes moderne, çështjet e

divorcit dhe përparimet në mjekësi. Në bazë të renditjes së fjalëve në këtë nen jeta e familjes është pozicionuar direkt në përkatësinë e sferës private ku ka të drejtën për të vepruar pa ndërhyrjen arbitrare të shtetit.

Duke trajtuar ndërhyrjen ”në përputhje me ligjin” u theksua se: “Që një ndërhyrje të jetë e justifikuar, ajo duhet të jetë në përputhje me ligjin, që paraqet masë mbrojtje kundër arbitraritetit”. Ndërsa lidhur me lirinë e vlerësimit u potencua se është i qartë fakti se Gjykata i jep Shtetit liri vlerësimi kur merr vendime nëse një ndërhyrje me një të drejtë të Nenit 8 justifikohet sipas paragrafit 2, të kësaj



dispozite. Liria e vlerësimit që i jepet autoriteteve kompetente vendase do të variojë në bazë të rrethanave, subjektit të çështjes dhe historikut të saj. Ajo ka identifikuar tashmë se faktorët që duhen marrë parasysh në përcaktimin e qëllimit të lirisë së vlerësimit në këtë fushë përfshijnë ekzistencën e arsyeve të përbashkëta ndërmjet ligjeve të shteteve kontraktuese; ndjeshmërinë e fushës që merret në konsideratë dhe ndryshueshmërinë në zakonet, politikat dhe praktikat midis shteteve kontraktuese. Trajnimi u shoqërua me raste nga praktika gjyqësore e GJEDNJ duke u shoqëruar me diskutime interaktive, përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore, u zbërthyen dhe u sqaruan dispozitat e nenit 8 të KEDNJ dhe ligjeve tjera në fuqi që rregullojnë këtë tematikë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e

## Aktgjykimi në procedurën kundërvajtëse

Më 13 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve në PTV, ka realizuar trajnimin me temë “Aktgjykimi në procedurën kundërvajtëse”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve në implementimin e drejtë të metodave bashkëkohore të hartimit, shkrimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaboruan çështjet rreth formave të vendimeve të cilat mund nxirren në procedurën kundërvajtëse. Vëmendje parësore iu kushtua ngritjes së shkathtësive në shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore (analizë e konstatimit të fakteve,

vlerësimit të provave dhe zbatimit të normës juridike-shembuj).

Paraprakisht, u trajtuan edhe zbatimi konsekuent i dispozitave ligjore që duhet të aplikuar kur do të hartohet një vendim gjyqësor për rastet kur vendoset për një çështje kundërvajtëse nga ana e gjykatës.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarët nga Divizioni i Kundërvajtjes nga regjionet e ndryshme të Kosovës.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata (VII)



Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë muajit dhjetor ka zhvilluar aktivitete në drejtim të përmbushjes së programit trajnuese, duke përfshirë trajnimin teorik, trajnimin praktik si dhe vizitat në institucione jo-gjyqësore.

Në këtë periudhë janë realizuar 16 sesione trajnimi nga modulet: Kodi i Procedurës Penale, Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare, Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Në kuadër nën modulit “Shpenzimet e procedurës” është realizuar një (1) sesion trajnues ku është trajtuar aktvendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Gjithashtu një (1) sesion trajnues është realizuar edhe nga nën moduli “Ngritja e shkathtësive” dhe është diskutuar rreth: Ngritjes së shkathtësive sociale për gjyqtarë dhe avancimi i performancës profesionale.

Nga nën moduli “Menaxhimi i stresit” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese nga ky nën modul me ç’rast gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja lidhur me menaxhimin e kohës si predispozite e

menaxhimit të stresit dhe mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i punës dhe jetës.

Po ashtu nga nën moduli: “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar” u realizuan dy (2) sesione trajnuese ku është përfshirë aspekti penal dhe civile, duke u fokusuar tek ekstradimi dhe urdhër arresti nga Konventa Evropiane si dhe ndihma juridike ndërkombëtare në çështje civile.

Gjatë realizimit të trajnimit teorik gjyqtarët kanë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese nga nën moduli “Kodi Penal-pjesa e përgjithshme”. Temat të cilat u trajtuan janë: Elementet veprës penale, objekti dhe subjekti i veprës penale, ndarja e veprave penale, veprimi vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale dhe kundërligjshmëria.

Gjithashtu nga nën moduli “Kodi Penal-pjesa e veçantë” u realizuan gjashtë (6) sesione trajnuese ndër të cilët gjyqtarët u informuan lidhur me: Veprat penale nga kapitulli XIV deri te kapitulli XXV dhe veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe lirive e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, në drejtim të përmbushjes së programit praktik trajnues, gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar trajnim në Administratën Tatimore të Kosovës dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit, ku gjyqtarët patën rastin të përfitojnë njohuri lidhur me punët të cilët i zhvillojnë këto institucione.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur (37) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.

## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VIII)

Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përmbushur duke realizuar aktivitetet si në vijim: gjithsej 18 sesione trajnuese janë realizuar nga modulet: Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Në kuadër të nën modulit “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese, ku prokurorët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja rreth arrestit shtëpiak, diversionit dhe paraburgimit.

Nga nën moduli “Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, me anë të cilëve prokurorët zgjeruan njohurit e tyre lidhur me pezullimin dhe pushimin e hetimeve, zgjerimi dhe rifillimi i hetimeve, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe dëshmitarët dhe procedimi i tyre gjatë fazës së hetimeve.

Gjatë realizimit të trajnimit teorik prokurorët kanë realizuar një (1) sesion nga nën moduli “Krimet e rënda” ku pjesëmarrësit u informuan me krimet e rënda, trafikimi me qenie njerëzore, shpëlarja e parave dhe krimi kibernetik.

Gjithashtu nga nën moduli “Roli i prokurorit në shqyrtim gjyqësor” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese ku u trajtuan: roli i prokurorit gjatë shqyrtimit fillestar, në shqyrtimin e dytë dhe në fjalën përfundimtare.

Po ashtu nga nën moduli “Procesverbalet” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese ndër të cilat janë shtjelluar: procesverbalet krijimi dhe mbajtja e tyre, procesverbalet e prokurorisë dhe shkresat e lëndëve.

Nga realizimi i sesioneve trajnuese në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar edhe dy (2) sesione nga nën moduli “Negocimi i marrëveshjes për pranim të fajësisë” ku u diskutua për subjektet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, inicimi i kësaj procedure dhe roli i prokurorit në këtë proces.

Në kuadër të nën modulit “Ushtrimi i mjeteve juridike” u realizua një (1) sesion trajnues me temë: “Përpilimi i ankesës nga prokurori i shtetit kundër aktvendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake”.

Gjithashtu, në drejtim të përmbushjes së programit praktik trajnues, prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar trajnimin në Administratën Tatimore të Kosovës dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit, ku prokurorët patën rastin të përfitojnë njohuri lidhur me punët të cilët i zhvillojnë këto institucione.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (10) ditë trajnimi praktik në prokurorit përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar.



## Trajnim praktik i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar me Administratën Tatimore të Kosovës

Më 03 dhe 04 Dhjetor 2019, Akademia në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar ka realizuar trajnimin praktik në institucionin e Administratës Tatimore të Kosovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të njoftohen për së afërmi me funksionet dhe zhvillimet e ATK-së, veprimtarinë e tyre, si dhe me sfidat të cilat ballafaqohet në praktikë ky institucion.

Në kuadër të këtij trajnimi është diskutuar lidhur me ndryshimet legjislative, llojet e bizneseve në Kosovë, kategorizimi i llojeve të bizneseve, regjistrimi i bizneseve, llojet e tatimeve që aplikohen në Kosovë, normat tatimore, tatimin mbi vlerën e shtuar, faturat dhe kuponët fiskal, TVSH-ja, të ardhurat bruto dhe neto, si dhe kontributet pensionale.

Me theks të veçantë u diskutua edhe për kreditimin, rimbursimin dhe kompetencat që ka Administrata Tatimore e Kosovës të ngrit padi ndaj tatim paguesve jo të rregullt pas periudhës së caktuar nga ATK për tatim paguesit.

Trajnim u realizua në formë të bashkëbisedimit ku gjyqtarët patën mundësi të diskutojnë dhe të shtjellojnë edhe shumë tema me interes të tyre lidhur me tatim paguesit, shpenzimet e lejuara dhe ndëshkimet përgjatë shkëljes ligjore të tatim paguesve.

Përfitues të trajnimit janë: Gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII), dhe prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VIII).



## Vizitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në Zyrën Kombëtare të Auditimit

Më 11 dhjetor 2019, në kuadër të programit trajnues për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar vizitën e radhës në zyrën Kombëtare të Auditimit.



Qëllimi i kësaj vizite/trajnitimit ishte që gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të krijojnë një pasqyrë të qartë rreth mandatit, bazës ligjore, rolit, strukturës organizative dhe përgjegjësisive të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Në kuadër të kësaj vizite/trajnitimit, Drejtori i Zyrës Kombëtare të Auditimit, bëri një prezantim të shkurtër të themelimit, mandatit dhe zhvillimit të këtij institucioni si dhe bashkëpunimin mes organeve të drejtësisë dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit lidhur me punët relevante të përbashkëta. Gjithashtu gjatë trajnimit gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar u informuan edhe me sfidat dhe vështirësitë me të cilat aktualisht ballafaqohen duke vepruar në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe duke iu referuar kodit etik

për sjelljet gjatë punës si dhe përgjegjësit që kryen ky institucion duke kryer auditimin vjetor në institucionet shtetërore si: Ministrinë, Komunat, Ekzekutivi dhe në bazë të kërkesave për Agjencitë e Pavarura dhe donatorëve që ndihmojnë me fonde.

Më tej në mënyrë të detajuar u trajtua pavarësia e Zyrës Kombëtare të Auditimit, funksionet e brendshme dhe të jashtme të auditimit, si dhe auditimi i rregullsisë dhe performancës duke pasur për qëllim miratimin e fondeve dhe ofrimin e procesit të mirëbesimit të populli dhe fondet të cilat shpenzohen.

Gjatë realizimit të trajnimit nga gjyqtarët dhe prokurorët u realizua edhe forma e bashkëbisedimit ku pjesëmarrësit shtrinin pyetje të interesave të përbashkëta në bashkëpunimin gjyqësor me ZKA-në ku në fokus ishte tema e raportimit të institucioneve në ZKA, trajtimi i qasjes në interes të publikimit të raporteve si dhe rastet ku mundë ta hasin në vepra penale dhe shkelje ligjore nga ZKA për institucionet shtetërore të cilat prezantojnë raporte financiare.

Përfitues të kësaj vizite ishin gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata (VII) 2019-2020 dhe prokurorët e sapo emëruar gjenerata e (VIII) 2019-2020



## Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

### Takimi i Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, më 23 dhjetor 2019, në Akademinë e Drejtësisë është zhvilluar takimi i radhës së Këshillit të Redaksisë së revistave të Akademisë së Drejtësisë.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i punimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së VI të gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjeneratës së VII të cilët e kanë përfunduar Programin e Trajnimit Fillestar dhe procesi i mëtutjeshëm deri në finalizimin e punimeve për publikim në revistën “Justicia”.

Me rastin e këtij takimi u shqyrtuan disa nga punimet të cilat kanë qenë nën redaktim nga Këshilli i Redaksisë për të cilat u potencua se ka shumë për tu bërë meqenëse autorët gjatë punimit nuk kanë respektuar standardet për publikim. dhe njëkohësisht diskutuan për pritjet

e tyre për revistën. Më tej gjatë shqyrtimit të punimeve u diskutua për pritjet që Këshilli i Redaksisë ka për revistën duke rekomanduar që punimet të kenë referenca më shumë në burime si dhe në praktikën gjyqësore.

Në fund të takimit anëtarët e Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë u pajtuan që deri me datën 15 janar të përfundojnë redaktimin e punimeve dhe të identifikojnë punimet të cilat plotësojnë kriteret për publikim.

Në takim përveç anëtarëve të Këshillit të Redaksisë morën pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Programit për Hulumtime dhe Publikime i Akademisë së Drejtësisë.

## Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

### Trafikimi me qenie njerëzore

Më 06 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE-së, implementuar nga Organizata Evropiane për Ligjin Publik/ELPO, realizoi trajnimin me temë: “Lufta kundër Trafikimit me qenie njerëzore”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte luftimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit në fuqi sa i përket këtyre veprave penale.

Fillimisht u trajtuan aspektet ligjore të Trafikimit me qenie Njerëzore, të kuptuarit e viktimës si dhe perspektivat e viktimës. Me fokus të veçantë ishte mbrojtja e viktimës para dhe gjatë zhvillimit të procesit penal, mbështetja, rehabilitimi i viktimës dhe ri integrimi i saj

në shoqëri.

Gjatë këtij trajnimi përmes rasteve praktike u vë në pah se trafikimi me qenie njerëzore është dukuri e përhapur dhe më fitimprurëse e krimin të organizuar, duke arritur dimensione të njëjta me trafikimin e drogës dhe të armëve. Andaj, u kërkua që pjesëmarrësit të kuptojnë drejt elementet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe të njohin format e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me njerëz në mënyrë që të ketë rezultate në luftimin e këtyre veprave.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial





## Shkathtësitë e buta

Më 10-11 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të për trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, realizoi trajnimin nga Moduli: 7 “Shkathtësitë e buta”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me konfliktet dhe tejkalimin e tyre si dhe avancimi i njohurive rreth programeve kompjuterike.

Në ditën e parë të trajnimit është diskutuar konflikti dhe klasifikimi themelor i konflikteve, konfliktet dhe përkufizimi teorik, problemet dhe barrierat tjera në punë, marrëdhëniet ndër njerëzore dhe ndër kolegjiale në punë, mandati formal dhe përgjegjësia individuale ndaj rrethit në punë, ruajtja nga “djegia” e profesionit, ruajtja dhe mbrojtja nga mobingu, tejkalimi i konflikteve, marrëdhënia e qëndrueshme paqësore

dhe modalitetet.

Gjate ditës së dytë është trajtuar aspekti i teknologjisë informative e cila është pjesë e modulit për Shkathtësitë e Buta. Në kuadër të këtij sesioni janë elaboruar paisjet harduerike dhe softuerike, programet kompjuterike si: microsoft word, microsoft outlook dhe chati (Lync). Po ashtu është diskutuar edhe hardueri siç janë: njësia qendrore, njësia artimetike-logjike, njësia e memories, njësit hyrëse, njësit dalje dhe njësitë e tjera.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjor dhe staf administrativ tjerë të gjykatave dhe prokurorive.



## Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor-Gr.I

Më 17 dhe 18 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me USAID/JSSP organizoj trajnimin me temë: “Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor”. Ky trajnim kishte për qëllim avancimin e njohurive të përkthyesve gjyqësor në tematikën e përkthimit konsektiv, në kuadër të aktiviteteve të Akademisë së Drejtësisë për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.



Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: Rëndësia e përkthimit konsektiv (video i shkurtë për rëndësinë e marrjes së shënimeve), analiza e fjalimit, hartat e strukturës dhe hartat e mendjes. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Identifikimi dhe ndarja e ideve, Softverët e përkthimit - trajnim i avancuar për përdorimin e Tradosit dhe roli i tij.

Që në fillim u potencua roli dhe rëndësia e përkthimit konsektiv në sistemin e drejtësisë duke zbrërthyer elementët përbërëse të tij. Njëkohësisht u vequra mendimi se roli i përkthyesve në këtë proces është shumë i rëndësishëm.

Në shembullin e parë u demonstrua analiza e një fjalimi përmes përkthimit konsektiv dhe mbajtjes së shënimeve e tërë kjo përmes video-inqizimit nga një program i rëndësishëm në internet me tematikë në lëmin gjyqësor. Përmes punës individuale dhe sqarimit të ekspertëve pjesëmarrësit patën rastin të përvetsojnë teknikën dhe veglat e zbrërthimit dhe

mbajtjes së shënimeve lidhur me një fjalim konkret. Në këtë kontekst përkthyesit mësuan hapat që duhet ndjekur ata për të bërë përkthim cilësor konsektiv përmes leximit të vazhdueshëm, leximin paraprak të materialeve, marrjes së shënimeve të vequara në blloqe në formë të shkurtëra-diagonale, etj. U potencua edhe roli i fjalorëve juridik në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, ku u vequra Fjalori shqip-serbisht (sprsko-albanski recnik), pastaj Fjalori i vogël-botimi i OSBE-së, botimi i Fjalorit shqip-serbisht-anglisht dhe gjermanisht nga AD-së dhe GIZ-i etj.

Në vazhdim u shpjeguan roli dhe mënyra e përdorimit të simboleve nga ana e përkthyesve pastaj, lidhjeve, shkurtesat e fjalëve, kllapat, forma e diagonales në mbajtjen e shënimeve dhe elemente tjera që i ndihmojnë përkthyesit në procesin e përkthimit konsektiv cilësor. Simbolet që përdoren u potencua se duhet të jenë konsistente, organike ndërsa shenjat që tregojnë simbolet duhet të jenë në formë të figurave dhe fotove. Më tej u shpjegua dhe u demonstrua praktikisht nga ekspertet përmes punës praktike në kompjuterë Programi SDL-Trados për të cilin u tha se paraqet një ndihmesë të konsiderueshme për përkthyesit gjyqësor në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Gjatë trajnimit u zbrërthyen të gjitha elementët e këtij programi përmes punës në grupe.

Po ashtu gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, metodologjitë e reja për përkthim konsektiv, raste nga praktika e përkthimeve në gjykata dhe prokurori duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbrërthyer standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore që rregullojnë këtë lëmi. Përfitues në këtë trajnim ishin përkthyesit e gjykatave dhe prokurorive të të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

## Bazat e përkthimit konsektiv ( marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor-Gr.II

Më 19 dhe 20 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me USAID/JSSP organizoj trajnimin me temë: “Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor”. Ky trajnim kishte për qëllim avancimin e njohurive të përkthyesve gjyqësor në tematikën e përkthimit konsektiv, në kuadër të aktiviteteve të Akademisë së Drejtësisë për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: Rëndësia e përkthimit konsektiv (video i shkurtë për rëndësinë e marrjes së shënimeve), analiza e fjalimit, hartat e strukturës dhe hartat e mendjes. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Identifikimi dhe ndarja e ideve, Softverët e përkthimit - trajnim i avancuar për përdorimin e Tradosit dhe roli i tij.

Që në fillim u potencua roli dhe rëndësia e përkthimit konsektiv në sistemin e drejtësisë duke zbërthyer elementët përbërëse të tij. Njëkohësisht u veqta mendimi se roli i përkthyesve në këtë proces është shumë i rëndësishëm.

Në shembullin e parë u demonstrua analiza e një fjalimi përmes përkthimit konsektiv dhe mbajtjes së shënimeve e tërë kjo përmes video-inqizimit nga një program i rëndësishëm në internet me tematikë në lëmin gjyqësor. Përmes punës individuale dhe sqarimit të ekspertëve pjesëmarrësit patën rastin të përvetsojnë teknikat dhe veglat e zbërthimit dhe mbajtjes së shënimeve lidhur me një fjalim konkret. Në këtë kontekst përkthyesit mësuan hapat që duhet ndjekur ata për të bërë përkthim cilësor konsektiv përmes leximit të vazhdueshëm, leximin paraprak të materialeve, marrjes së shënimeve të vequara në blloqe në formë të shkurtëra-diagonale, etj. U potencua edhe roli i fjalorëve juridik në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, ku u veqta Fjalori

shqip-serbisht (sprpsko-albanski recnik), pastaj Fjalori i vogël-botimi i OSBE-së, botimi i Fjalorit shqip-serbisht-anglisht dhe gjermanisht nga AD-së dhe GIZ-i etj.



Në vazhdim u shpjeguan roli dhe mënyra e përdorimit të simboleve nga ana e përkthyesve pastaj, lidhjeve, shkurtesat e fjalëve, kllapat, forma e diagonales në mbajtjen e shënimeve dhe elemente tjera që i ndihmojnë përkthyesit në procesin e përkthimit konsektiv cilësor. Simbolet që përdoren u potencua se duhet të jenë konsistente, organike ndërsa shenjat që tregojnë simbolet duhet të jenë në formë të figurave dhe fotove. Më tej u shpjegua dhe u demonstrua praktikisht nga ekspertet përmes punës praktike në kompjuterë Programi SDL-Trados për të cilin u tha se paraqet një ndihmesë të konsiderueshme për përkthyesit gjyqësor në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Gjatë trajnimit u zbërthyen të gjitha elementët e këtij programi përmes punës në grupe.

Po ashtu gjatë këtij trajnimit u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, metodologjitë e reja për përkthim konsektiv, raste nga praktika e përkthimeve në gjykata dhe prokurori duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore që rregullojnë këtë lëmi. Përfitues në këtë trajnim ishin përkthyesit e gjykatave dhe prokurorive të të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

## Aktivitetet tjera

### Konferenca përmbyllëse e projektit iPROCEEDS – Vlerësimi i progresit të arritur dhe rruga e më tutjeshme

Më datë 09-10 dhjetor 2019, në Strasburg të Francës është realizuar Konferenca përmbyllëse e projektit iPROCEEDS - Vlerësimi i progresit të arritur dhe rruga e më tutjeshme në fushën e Krimin Kibernetik dhe provat elektronike.

Qëllimi i Konferencës përmbyllëse ishte vlerësimi i progresit në secilën nga shtatë fushat e projektit për periudhën 2016 - 2019, duke u bazuar në rezultatet e shtatë misioneve të vlerësimit përfundimtar, Raportin fillestar të situatës së hartuar në fillim të projektit dhe kornizën logjike të projektit, me theks të veçantë në treguesit e performancës lidhur me Krimin kibernetik, provat elektronike, hetime financiare dhe shpërlaja e parave.

Fokusi i kësaj Konference ishte rishikimi i rezultateve dhe sfidat që kishin gjatë implementimit të projektit, shkëmbimi i praktikave më të mira, studimet e rasteve dhe sukseset e arritura gjatë 48 muajve të fundit në fushën e krimin kibernetik, provat elektronike. Pjesëmarrësit në konferencë u njoftuan lidhur me fillimin e projektit të ri bazuar në vlerësimin e nevojave që kanë institucionet trajnuese në lidhje me fushën e Krimin Kibernetikë në zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Pjesëmarrësit gjatë kësaj konference shkëmbyen përvojat e tyre, praktikat me të mira si dhe nevojat dhe prioritet që kanë të bëjnë me këtë fushë si dhe hapat që duhet ndërmarr në lidhje me një rrjet të trajnerëve gjyqësorë vendas për krimin kibernetikë dhe provat elektronike. Kjo konferencë është mbështetur nga Këshilli i Evropës ku kanë marr pjesë: Anëtarët e ekipit të projektit - Njësitë e krimin kibernetik, Njësitë e hetimit financiar, Prokurorë, Njësitë e Intelligjencës Financiare (NJIF), Ministria e Drejtësisë, Trajnuesit vendorë si dhe Institucionet e trajnimit gjyqësor nga Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Turqia.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Prokurorë, Trajnues të Akademisë në këtë fushë, Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë nga Ministria e Drejtësisë, Shefi i Sektorit për Hetim të Krimin Kibernetik - Policia e Kosovës, Udhëheqësi i Njësitit për Hetime të Integruara Financiare- Policia e Kosovës, Përfaqësues nga Departamenti për Trajnime të Avancuara dhe Specializuara - Policia e Kosovës si dhe Zyrtarja e lartë nga PTV, Akademia e Drejtësisë.



**Punëtori për hartimin e Planit të Punës për vitin 2020 dhe monitorimi i Planit Punës dhe të Planit Strategjik për periudhën korrik – dhjetor 2019**

Nga data 10-11 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë ka realizuar një punëtori për hartimin e Planit të Punës së Akademisë për vitin 2020 dhe njëkohësisht për monitorimin e Planit Strategjik për periudhën Korrik-Dhjetor 2019.

Grupi punues fillimisht ka monitoruar zhvillimet dhe aktivitetet e realizuara gjatë periudhës korrik –dhjetor 2019 të cilat kanë qenë të planifikuara me Planin Strategjik 2019-2021 e më pastaj ka përcaktuar strukturën dhe objektivat e secilit program trajnues, prioritetet për periudhën një (1) vjeçare dhe ka hartuar Planin e Punës për vitin 2020.

Bazuar në strukturën e këtij plani grupi punues ka hartuar edhe planin e veprimit i cili është pjesë e planit të punës me të cilin grupi punues ka përcaktuar prioritetet e punës, aktivitetet, njësitë përgjegjëse, veprimet, afatin kohor për realizimin e tyre si dhe treguesit apo rezultatet e arritura nëpërmjet këtyre aktivitetëve.

Pjesëmarrës ishin Drejtori Ekzekutiv, Trajnuesit e përhershëm, stafi nga Departamenti i Programit dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.

## Trajnim për trajnues

### “Regjimi pasuror i bashkëshortëve: Pronësia e përbashkët dhe kontrata martesore”

Më 06 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e Bashkimit Evropian-Projekti për Kodin Civil organizoj trajnimin për trajnues me temë: “Regjimi pasuror i bashkëshortëve- Pronësia e përbashkët dhe kontrata martesore”. Ky trajnim ishte në funksion të përgatitjes së trajnuesve për trajnimet që do të organizohen në të ardhmen dhe avancimin e njohurive të tyre lidhur me risitë që do të sjell Kodi Civil i Republikës së Kosovës i cili është në fazën e miratimit të tij.

Në trajnimi fokusi ishte në: risitë që përmban Kodi i Civil i Kosovës mbi Regjimin e pasurisë bashkëshortore/Pasuria e vecantë dhe e përbashkët, Ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe Kontratën martesore si dhe nevojat e metodologjia që do të përdoret në trajnimet vijuese mbi këto risi.

Që në fillim u zbërthyen disa komponente që e bëjnë një trajnim të suksesshëm si: Përzgjidhja e temës së qëlluar bazuar në nevojat për trajnim dhe një planifikim paraprak, Përzgjedhja e trajnuesit kompetentë për temën e trajnimit, Përgatitja e materialit dhe shpërndarja, Përshtatja e trajnimit audiencës-pjesëmarrësve, Përzgjedhja e metodës adekuate për bartjen e njohurive për temën, Përdorimi i rasteve studimi (raste të gjykatës që janë më të diskutueshme), Puna në grupe të vogla, Diskutimi i hapur i pjesëmarrësve, Rekomandime për zgjidhje të rasteve dhe Vlerësimi i trajnimit.

Në vazhdim u prezentuan zhvillimet e fundit në Projekt-Kodin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin do të bëhen zhvillime të rëndësishme në të drejtat pronësore. Lidhur me tematikën e veqar u potencua se aktualisht është në fuqi Ligji i Familjes i Kosovës. Ky ligj zbatohet deri në hyrjen në fuqi - miratimin e Kodit Civil. Marrëdhëniet pronësore në martesë dhe bashkëjetesë rregullohen me LFK. Me

ndryshimet e LFK në vitin 2018, publikuar në GZ., me 17 janar 2019, pjesët e pasurisë dhe kontributet e bashkëshortëve janë të barabarta, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe. Edhe në Kodin Civil, kontributet janë të barabarta, përveç nëse ka marrëveshje paramartesore ose martesore.

Rregullat e regjistrimit mbeten të njëjta në Kodin Civil, Koncepti i bashkëjetesës është sqaruar më mirë në Kodin Civil. Ndërsa rregullat e pjestimit ndryshojnë me miratimin e Kodit Civil. Sipas LFK në fuqi, me ndryshimet



në vitin 2019, kontributet e bashkëshortëve janë të barabarta dhe Kërkesat për pjestim mund të paraqiten në mënyrë të njëjtë dhe nga personat e njëjtë. Gjithashtu rregullat e pjestimit mbeten të njëjta sa i përket procedurës dhe organit kompetentë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, u demonstruan metodat bashkëkohore të ligjërimit, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe shoqëruar me diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore dhe standardeve bashkëkohore të metodologjisë së mësimdhënies si dhe dispozitave ligjore që përmban Projekt-Kodi Civil i Kosovës.

Përfitues në këtë trajnim ishin trajnuesitë gjyqësor të Akademisë së Drejtësisë që do të ligjërojnë në të ardhmen për Kodin Civil të Republikës së Kosovës.

## Tryezë e rrumbullakët: Risitë e Kodit Civil

Më 13 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e Bashkimit Evropian-Projekti për Kodin Civil organizoj tryezën e rrumbullakët me temë: “Risitë e Kodit Civil”. Kjo tryezë ishte në funksion të përgatitjes së trajnuesve për trajnimet që do të organizohen në të ardhmen dhe avancimin e njohurive të tyre lidhur me risitë që do të sjell Kodi Civil i Republikës së Kosovës i cili është në fazën e miratimit të tij.



Me rastin e këtij trajnimi fokusi ishte në: Risitë e Kodit Civil, sfidat në implementimin e dispozitave të reja të KC / Ndërtimi i kapaciteteve / Komentaret ligjor dhe nevojat e metodologjia që do të përdoret në trajnimet vijuese mbi këto risi.

Që në fillim u prezentuan zhvillimet e fundit në Projekt-Kodin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin do të bëhen zhvillime të rëndësishme në të drejtat pronësore si: Janë harmonizuar dispozitat ligjore dhe Kodi përmban 5 Libra: Libri 1- Pjesa e përgjithshme, Libri 2- Detyrimet, Libri 3- Pronësia dhe të drejtat tjera sendore, Libri 4- Familja, dhe Libri 5- Trashëgimia. Ky Kodi Civil do të ketë gjithësejt 1632 nene dhe është në procedurë të miratimit në Qeveri.

Më tej në trajnim u veçuan risitë që sjell Kodi Civil i Republikës së Kosovës si në vijim: duke bërë përkufizimet e pronësisë, janë specifikuar dhe sqaruar kuptimi i dispozitave ligjore, personat e huaj mund të fitojnë të drejta sendore, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë, është sqaruar mirëbesimi dhe

keqbesimi, për pronësinë në kafshë, ka rregulla të veçanta, janë përcaktuar llojet e pronësisë - publike dhe private, janë sqaruar të drejtat fqinjësore, janë rregulluar mënyrat e fitimit të pronësisë dhe titujt juridik.

Më tej duke trajtuar fitimin dhe humbjen e pronësisë dhe titujt juridik sipas Kodit Civil u theksua se ky Kod i ka specifikuar titujt juridik për fitimin e pronësisë (nenet 863-898 i KC). E drejta e pronësisë mund të fitohet në bazë të punës juridike, trashëgimisë, vendimit gjyqësor, vendimit të organit administrative dhe në bazë të ligjit (neni 863 i KC). E drejta e pronësisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, fitohet nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara me këtë Kod lidhur me fitimin e pronësisë në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme.

Ndërsa për fitimin e pronësisë me punë juridike (neni 864 i KC) u potencua se: 1. Pronësia kalon nga ish-pronari tek fituesi përmes një pune të vlefshme juridike, sipas mënyrës të përcaktuar me ligj, 2. Çdo punë juridike e vlefshme, qëllimi i së cilës është fitimi i pronësisë së një prone të paluajtshme, duhet të bëhet me shkrim dhe në formë të aktit noterial dhe 3. Puna juridike e vlefshme i referohet punës juridike të paraparë në Librin (2) dy të këtij kodi, dhe rregullave mbi testamentin të paraparë në Librin 5 të këtij kodi. Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesëshëm teorik, u demonstruan metodat bashkëkohore të ligjërimit, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe shoqëruar me diskutime interaktive, analizës së rasteve studimore dhe standardeve bashkëkohore të metodologjisë së mësimdhënies si dhe dispozitave ligjore që përmban Projekt-Kodi Civil i Kosovës.

Përfitues në këtë trajnim ishin trajnuesit gjyqësor të Akademisë së Drejtësisë që do të ligjërojnë në të ardhmen për Kodin Civil të Republikës së Kosovës dhe gjyqtarët e lëmisë civile

## Takimi ndërmjet drejtorit Ekzekutiv të AD-së dhe Kryesuesit të KGJK-së

Prishtinë, 17 dhjetor 2019, z. Enver Fejzullahu – Drejtor Ekzekutiv dhe znj. Valmira Pefqeli-U.D. e Koordinatorit të Programit në Akademinë e Drejtësisë kanë zhvilluar një takim të përbashkët me z. Skender Çoçaj – Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.


Qëllimi i këtij takimi ishte bashkëpunimi i KGJK-së dhe AD-së në interes të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi.

z. Enver Fejzullahu, falënderojë Kryesuesin e KGJK-së për ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme që ky institucion i ka dhënë Akademisë së Drejtësisë, si dhe theksoje nevojën dhe gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet të dy institucioneve edhe gjatë mandatit të tij si Drejtor Ekzekutiv i

Akademisë së Drejtësisë.

z. Skender Çoçaj, potencoi se të dy institucionet duhet vazhduar bashkëpunimin në hartimin e moduleve trajnuese, në zhvillimin e trajnimeve dhe në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në mënyrë që efekti i trajnimeve të rezultojë në efikasitetin e punës praktike të gjyqtarëve

Në fund të takimit bashkëbiseduesit u pajtuan që të vazhdoj koordinimi reciprok për funksionimin më të mirë dhe më cilësor të programeve trajnuese dhe shërbimeve tjera që ofron Akademia e Drejtësisë.





## Takimi i Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, më 23 dhjetor 2019, në Akademinë e Drejtësisë është zhvilluar takimi i radhës së Këshillit të Redaksisë së revistave të Akademisë së Drejtësisë.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i punimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së VI të gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjeneratës së VII të cilët e kanë përfunduar Programin e Trajnimit Fillestar dhe procesi i mëtutjeshëm deri në finalizimin e punimeve për publikim në revistën “Justicia”

Me rastin e këtij takimi u shqyrtuan disa nga punimet të cilat kanë qenë nën redaktim nga Këshilli i Redaksisë për të cilat u potencua se ka shumë për tu bërë meqenëse autorët gjatë punimit nuk kanë respektuar standardet për publikim. dhe njëkohësisht diskutuan për pritjet

e tyre për revistën. Më tej gjatë shqyrtimit të punimeve u diskutua për pritjet që Këshilli i Redaksisë ka për revistën duke rekomanduar që punimet të kenë referenca më shumë në burime si dhe në praktikën gjyqësore.

Në fund të takimit anëtarët e Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë u pajtuan që deri me datën 15 janar të përfundojnë redaktimin e punimeve dhe të identifikojnë punimet të cilat plotësojnë kriteret për publikim.

Në takim përveç anëtarëve të Këshillit të Redaksisë morën pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Programit për Hulumtime dhe Publikime të Akademisë së Drejtësisë.

## Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë



Prishtinë, 24 dhjetor 2019, në Akademinë e Drejtësisë, u mbajt takimi i njëzetënjëti me radhë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i Planit të punës së AD-së për vitin 2020 dhe miratimi i tij si dhe aktiviteteve tjera që janë në proces të zhvillimit brenda mandatit të Akademisë.

Fillimisht me rastin e këtij takimi, Kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit Drejtues i uruan mirëseardhje z. Enver Fejzullahu në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë. Në vijim shqyrtuan Planin e Punës së AD-së duke vënë në pah sfidat dhe rreziqet të cilat mund të hasen gjatë zbatimit të tij në praktikë për të cilat Këshilli Drejtues ofroi mbështetjen e tij në tejkalimin e tyre. Të gjithë njëzëri konfirmuan se përmbajtja e këtij dokumenti është e mirë dhe zbatimi i tij është në suaza të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, Planit Strategjik për vitin 2019-2021 dhe Programit të trajnimit për vitin 2020 të Akademisë.

Në këtë takim Këshilli Drejtues, diskutoi edhe për çështje të tjera që janë me rëndësi për funksionimin e Akademisë së Drejtësisë.

## Takimi me Trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë

Më 26 dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë, mbajti takimin me trajnuesit që do të angazhohen për realizimin e aktiviteteve trajnuese në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm për periudhën janar-qershor 2020.



Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi i trajnueseve me Drejtorin e AD-së, roli dhe kompetenca e trajnuesve në realizimin e trajnimeve dhe përmbushjen e Programit Trajnues, në mënyrë që trajnimet e realizuara të reflektojnë në punën e përfitueseve të AD-së.

Gjatë takimit u prezantuan format për hartimin e materialit për trajnime, detyrimet që e përcjellin trajnuesin me rastin e angazhimit në trajtimin e temave varësisht nga fusha, afatet kohore për përcjelljen e materialit trajnues në Akademi, pjesëmarrja në trajnime, përfshirjen e bashkëpunëtorëve profesional në trajnime të vazhdueshme, si dhe çështje tjera me rëndësi rreth trajnimeve në PTV.

Trajnuesit nga ana tjetër, duke i uruar drejtorit suksese në punë, potencuan që janë të gatshëm për bashkëpunim për ofrimin e trajnimeve sa më cilësore.

Në fund të takimit, znj. Melihate Rama njoftoi trajnuesit së janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për trajnimet që janë planifikuar të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020.



**<https://ad.rks-gov.net>**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**